



Duke u mbështetur në nenin 43 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale Nr.03/L-040, nenit 47,48 dhe 49 të Statutit të Komunës dhe nenit 4 të Rregullores për Punë të Kuvendit dhe Komiteteve të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës bënë këtë:

NJOFTIM

Njoftohen të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës së Klinës që të marrin pjesë në Seancën e VII-të të punës për vitin 2016, që do të mbahet me 29.07.2016 në sallën e Kuvendit të Komunës së Klinës duke filluar me punë në orën 10:00. Kërkohet nga anëtarët e Kuvendit që të marrin pjesë në seancë, ndërsa në rast të mungesës eventuale - mungesa duhet të arsyetohet me shkrim para mbajtjes së mbledhjes. Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në seancë, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL-së.

Lidhur me këtë seancë propozohet ky:

RENDI I DITËS

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Shqyrtimi dhe vënia në miratim e Raportit të menaxhimit financiar të komunës për periudhën janar-qershor 2016 (ref.Drejt.FEZH)
4. Informatë rreth Kontratës së Ndërtimit të Sheshit-Rrugët në qytet-infrastruktura nëntokësore dhe mbitokësore (ref.Drej.Urbanizmit dhe MM)
5. Pyetje dhe Përgjigjeje

01Nr. 06-3271 2016
Klinë, më 20.07 2016

